



WATER AND WASTE REGULATORY OFFICE
ZYRA RREGULLATORE PËR UJË DHE MBETURINA
REGULATORNI URED ZA VODU I OTPAD

RAPORT
PËR VLERËSIM TË APLIKACIONIT PËR TARIFA TË SHERBIMIT
TË NH “IBER-LEPENCI’ SH. A. PRISHTINË
PËR VITIN TARIFOR 2009

Shkurt 2009

Punuar nga:
Departamenti për Financa dhe Tarifa i ZRRUM

Ne këtë raport janë përshkruar detajet e procesit të përcaktimit të tarifave dhe mënyra e llogaritjes së tyre për shërbimet e Furnizimit me Ujë me Shumicë të pa trajtuar nga NH “Ibër-Lepenci” Sh.A. Prishtinë, për KUR “Mitrovica” Sh. A. Mitrovicë dhe për KUR “Prishtina” Sh. A. Prishtinë gjatë këtij cikli tarifor.

Akronimet

- ZRRUM Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina në Kosovë
- NH Ndërmarrja Hidroekonomike
- KUR Kompanitë e Ujësjetësve Regjional
- TKPK Trusti për Kursime Personale në Kosovë
- MMPH Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë të Kosovës
- P/F Pasqyrat financiare
- DFT Departamenti për Financa dhe Tarifa

Përmbajtja

Përmbledhja ekzekutive.....	5
1. Baza ligjore.....	7
2. Përcaktimi i tarifave dhe procesi i konsultimit	7
3. Shqyrtimi i të dhënave të siguruara.....	7
4. Baza për llogaritje të tarifave dhe alokimit të shpenzimeve	8
4.1. Baza për llogaritjen e tarifave	8
4.2. Alokimi i shpenzimeve për vitin 2009.....	8
4.3. Shqyrtimi i metodologjisë së alokimit të shpenzimeve	9
5. Përcaktimi i tarifave	9
5.1. Pagat dhe mëditjet.....	10
5.2. Ri-alokimi i stafit	11
5.3. Pagesat për MMPH	11
5.4 Ndarja e shpenzimeve të njësisë dhe administratës	11
5.5 Totali i shpenzimeve me kufirin e lejuar të fitimit.....	11
5.6. Tarifa për Mitrovicë	11
5.7. Tarifa për Prishtinë.....	11
6. Gjendja financiare.....	12

Përmbledhja ekzekutive

Sikurse edhe ne dy proceset paraprake të përmbyllura për tarifat e caktuar për Ndërmarrjen Hidroekonomike “Ibër-Lepenc” Sh. A. Prishtinë edhe ky proces po udhëhiqet, ekzekutohet dhe realizohet sipas parimit të mbulimit të kostove operative dhe një pjesë të shpenzimeve për projektet investive që i përkasin shërbimit të shitjes së ujit me shumicë e mbuluar me normen e përcaktuar të fitimit.

Infrastruktura e ndërtuar dhe e menaxhuar nga “Ibër-Lepenci” si ndërmarrje hidroekonomike; ka pas dhe aktualisht ka qellim primarë ujitjen e tokave bujqësorë për gjatë kanaleve të saja të irigacionit, pastaj prodhimin të energjisë elektrike nga penda e Ujëmanit, furnizimin me ujë me shumicë të sistemeve të furnizimit të qyteteve të; Mitrovicës, Vushtrrisë, Skenderajt dhe Drenasit, pastaj edhe të furnizimit me ujë industrial të objekteve termoenergjetike të Kosovës në Kastriot.

ZRRUM-i si autoritet i pa varur bënë rregullimin ekonomik të njësisë së furnizimit me ujë me shumicë të ujësjellësve regional të Mitrovicës dhe të Prishtinës për Drenas. Ky rregullim ekonomik nënkupton përcaktimin e tarifave ekonomike për këto shërbime me të cilat mbulohen shpenzimet operative dhe një pjesë të projekteve investive për mirëmbajtje dhe menaxhim të mirë të rrjetit me të cilin furnizohen kompanitë e ujësjellësit në Mitrovicë dhe Prishtinë.

ZRRUM-i duhet të përcaktojë tarifa të tilla me të cilat nuk do të ngarkohen konsumatorët e shumët, shtëpiak, komercialo-industrial dhe ata institucional me shpenzime që i përkasin njërive të tjera punuese të cilat veprojnë në kuadër të ndërmarrjes “Ibër-Lepenc”.

NH “Ibër-Lepenc” për nevoja të pasqyrimin të veprimtarisë së vet, vepron me tri njësi punuese, dhe atë:

1. Njësia për prodhimin e energjisë elektrike,
2. Njësia ujit të pa trajtuar me të cilën furnizohen dy kompanitë regjionale të ujësjellësve dhe industria, dhe
3. Njësia për sistemin e ujitjes

Duhet theksua se kjo ndarje nuk përputhet me strukturën organizative të pasqyruar nga ndërmarrja në planin e saj të biznesit për vitin 2009, pasi që në Plan të Biznesit për vitin 2009 e njëjta ka deklarua dy njësi dhe atë; Njësinë e Ujit dhe Njësinë e Ujitjes.

Sasia e furnizimit të ujit të pa trajtuar me shumicë për kompanitë regjionale në totalin e sasisë së ujit të furnizuar merr pjesë me vetëm 5,86% të sasisë së përgjithshme të ujit të furnizuar, ku hynë:

a) furnizimi për prodhim të energjisë elektrike	262.294.160 m3,
b) furnizimi për sistemet e ujësjellësve regjional	17.817.840 m3,
c) furnizim me ujë të Kosovës A dhe B	14.234.400 m3,
d) furnizimi i Feronikelit me ujë	3.153.600 m3,
e) <u>furnizimi i ujit për sistemet e ujitjeve</u>	<u>6.500.000 m3</u>
Gjithsejtë:	304.000.000 m3

ZRRUM`i konsideron se ujësjellësit regjional të Mitrovicës dhe Prishtinës për Drenas, duhet të paguajnë shpenzimet e veta në proporcion të sasisë së ujit të furnizuar nga Ujëmani dhe nga gjatësia e prurjes së ujit me kanal, deri te vendi i trajtimit të mëtutjeshëm të ujit. Këto dy kompani nuk duhet të ngarkohen me shpenzimet e sistemeve tjera.

Metodologjia për alokim të shpenzimeve për ujin e pa trajtuar për ujësjellësit regjional duhet të jetë transparente dhe kjo duke u mbështetur në vëllimin e ujit të pranuar dhe në distancën deri në piken e furnizimit. Këto dy komponente do të përdoren edhe gjatë këtij procesi tariforë, të deklaruar si “metër kub – kilometër” . Kjo do të përshkruhet në pjesën e pestë të këtij vlerësimi.

1. Baza ligjore

Me rastin e përcaktimit të tarifave të kësaj ndërmarrje, ZRRUM`i mbështet në Ligjin Nr. 03/I-086 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2004/49 për veprimtaritë e ofruesve të shërbimeve të ujësjellësit, kanalizimit dhe të mbeturinave, dhe veçanërisht në:

- Nenin 10.3 (d): “Mjaftueshmëria e tarifave të Shërbimit që mbulojnë shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes të Ofruesit të Shërbimeve dhe planeve tjera të shpenzimeve kapitale të aprovua nga rregullatori”, dhe
- Nenin 10.3 (k): “Tarifa e Ujit me Shumicë merr parasysh shpenzimet e furnizimit të ofruesit relevant të shërbimeve me Ujin me Shumicë dhe kufirin e duhur të fitimit për furnizuesit e ujit me shumicë”.

2. Përcaktimi i tarifave dhe procesi i konsultimit

NH “Ibër-Lepenc” Sh. A. Prishtinë ka aplikuar për Tarifa të shërbimit të Ujit me Shumicë me 20 janar 2009. Para asaj kohe ZRRUM ka mbajtur takim me përfaqësuesit e kësaj ndërmarrje dhe janë harmonizuar kriteret për kushtet dhe afatet e aplikimit për të përcaktuar tarifat e këtij cikli tarifar.

3. Shqyrtimi i të dhënave të siguruara

ZRRUM`i me shkresën e vet Nr. 9/3D, datë 22 janar 2009 ka konfirmuar pranimin e aplikacionit të “Ibër-Lepenci” me çka ka futur në procedurë të rregullt analizën dhe vlerësimin e të dhënave operative dhe financiare për përcaktim të tarifave të këtij vitit tarifar.

Në shumicën e rasteve të dhënat e pasqyruar në Shtojcën Nr. 3. Tabela për kalkulimin e tarifave të ujit me shumicë është në përputhje me të dhënat e pasqyruar në Planin e Biznesit të vitit 2009, me përjashtim të;

1. sasisë së ujit të furnizuar për KUR “Prishtina” Sh. A. Prishtinë për Drenasin pasi që kur krahasohen këto dy dokumente kemi një mos përputhje për 400.000 m3 ujë në vit,
2. numri i të punësuarve nuk përputhet në këto dy dokumente, pasi që ndryshimi në mesë njërit dhe tjetrit dokument është për (204-226) 22 të punësuar,
3. ZRRUM`i mendon se ndarja sipas skemës suaj organizative; njësia afariste e “Ujit” dhe e “Ujitjes” është jo e mjaftueshme, pasi që përkufizim i sakët për procesin tarifar do të ishte ndarja proporcionale sipas njësive që i shërben me uji ndërmarrja e ujit dhe ajo mund të jetë; ujë me shumicë, uji industrial, ujitje dhe uji për prodhimin e energjisë elektrike,
4. ZRRUM`i duhet ta rishikojë modelin softuerik për proceset e ardhshme tarifore pasi që është e dukshme se në disa pjesë mund të jetë ma i qartë.

ZRRUM mendon se ndarja obligative për ndërmarrjen në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës në shumën bruto prej 20% të Fondit të pagave është e pa arsyeshme dhe jo e aprovuar nga kjo zyrë dhe të dy kategoritë tjera të shpenzimeve.

Po ashtu mendojmë se ndarja e shumave për investime në menaxhim dhe mirëmbajtje të aseteve ekzistuese është jo drejt e ndarë pasi që sipas proporcionit që të gjitha njësit shërbyese me ujë duhet të participin në mbulimin këtyre shpenzimeve.

4. Baza për llogaritje të tarifave dhe alokimit të shpenzimeve

4.1. Baza për llogaritjen e tarifave

Nenet mbështetëse në të cilat bazohet ZRRUM`i për të përcaktuar tarifat e kësaj ndërmarrje janë theksuar në piken 2. Baza ligjore dhe atë sidomos të , Neni 10.3 (k) i cili zbatohet vetëm te uji me shumicë dhe si i tillë i njëjti mund të ketë ndikim ma të madh në vendosjen e tarifave të Ujit me Shumicë, se sa neni 10.3 (d). Prandaj kjo tarifë do të përcaktohet me lejimin e kufirit të fitimit si shtesë te kostot e furnizimit.

Ky kufi përcaktohet në lartësinë faturimit për vitin 2009 për 20%, dhe të njëjtin e mbështesim si % mesatare e cila praktikohet në disa ndërmarrje të ujësjellësve të shteteve të BE-së.

4.2. Alokimi i shpenzimeve për vitin 2009

Për kostot e prodhimit dhe shpërndarjes së sasive të ujit të kontraktuara nga “Ibër-Lepenci” si ndërmarrje furnizuese e ujit me shumicë të pa trajtuar të KUR`ve të “Mitrovicës” dhe të Prishtinës” për Drenas, është e domosdoshme të bëhet një alokim dhe përkufizim i saktë, i drejtë dhe transparent i të dhënave të tilla të cilat e mbështesin vendimin e ZRRUM`it.

ZRRUM`i mendon se furnizimi i ujësjellësve të “Mitrovicës” dhe Prishtinës” për Drenas nënkupton ngarkimin me shpenzime proporcionale të rezervuarit dhe kanalit deri te pikat e tyre të furnizimit ku këto dy kompani e marrin sasinë e ujit të tillë në trajtim të matutjeshëm. Këto dy kompani nuk duhet të ngarkohen me shpenzimet e prodhimit të hidroenergjisë, ujit industrial dhe rrjetet të ujitjes.

Metodologjia e alokimit të kostos do të përpiqet të marrë parasysh vëllimin e ujit të furnizuar dhe distancën e kaluar deri te pika e furnizimit (dhe pjesën e infrastrukturës së përdorur). Kjo do të bëhet me anë të llogaritjes së “**metrave kub – kilometra**” për secilin konsumatorë veç e veç .

Tabela 1: Alokimi i kostove

Nr. rendor	Konsumatorët	Gjatësia deri te konsumatori (km)	Sasia e ujit të furnizuar (m3)	Të dhënat për m3/km	Shpenzimet e shprehura në (%)
1	Mitrovica	17.5	15,768,000	275,940,000	19.039028
2	Prishtinë (Drenas)	45.8	2,049,840	93,882,672	6.477621
3	Kosova A dhe B	49.0	14,234,400	697,485,600	48.124404
4	Feronikeli	49.0	3,150,000	154,350,000	10.649684
5	Ujitja	13.8 – 45.8	6,500,000	227,680,375	15.709259
Gjithsejtë:			41,702,240	1,449,338,647	99.999999

Me këto demonstron se ZRRUM ka bërë këto llogaritje për konsumatorët e lartë cekur nga ku do të nxjerr treguesit për shitjet e ujit edhe pse këtu nuk ka hy sasia e ujit që shfrytëzohet për prodhimin e energjisë elektrike.

ZRRUM konsideron se kompania ka pas parasysh për shumën e investimeve e cila i përket sektorit të prodhimit të energjisë dhe me të njëjtat nuk do ti ngarkon sistemin e furnizimit të Ujit me Shumicë për dy kompanitë regionale.

4.3. Shqyrtimi i metodologjisë së alokimit të shpenzimeve

Me qëllim të ngritjes së shkallës së transparencës në procesin e përcaktimit të tarifave, ZRRUM`i do ti pasqyrojë të dhënat për alokimin e shpenzimeve operative dhe kapitale në tri qendra përfituese të kësaj kompanie.

Megjithëse në Plan të Biznesit të “Ibër-Lepencit” është skematizua organizimi i brendshëm vetëm me dy Njësi afariste “Uji” dhe “Ujitja” është evidente se në te do të duhej të gjindej edhe njësi e prodhimit.

ZRRUM do ti pasqyrojë të njëjtat si tri njësi përfituese me shtatë qendra të shpenzimeve.

Tabela 2: Alokimi i shpenzimeve sipas qendrave përfituese dhe qendrave shpenzuese

Nr. Rend	Qendrat përfituese	Qendrat shpenzuese						
		Rezervuari i pendës	Prodhimi	Penda e ujit	Kanali në drejtim të KEK-ut poshtë KEK-ut		Rrjeti i Ujitjes	Menaxhimi Qendror
1	Prodhimi	x	x					x
2	Uji	x		x	x			x
3	Ujitja	x		x	x	x	x	x

ZRRUM kërkon që shpenzimet operative, shpenzimet kapitale dhe asetet fikse të analizohen sipas formës së lartpërmendur për vitet 2009 e tutje, si pjesë e regjistrit të tarifave të vitit 2009.

5. Përcaktimi i tarifave

Përmbledhja e llogaritjeve të tarifave është e paraqitur më poshtë dhe e diskutuar në vijim.

Tabela 3: Shpenzimet operative të deklaruar dhe ato të aprovuara nga ZRRUM

Nr. Rend	Zërat e shpenzimeve	Mbështetja në Raport	Të dhënat deklaruar nga ndërmarrja në vite (EUR)				Shuma e lejuara nga ZRRUM 2009 (EUR)
			2006	2007	2008	2009	
1	Pagat dhe mëditjet	6.1	890,925	864,121	854,686	768,993	718,726
2	Energjia elektrike		45,295	34,071	60,690	67,586	78,199
3	Materialet		163,400	161,491	141,086	216,505	159,273
4	Sigurimi		1,632	1,528	2,166	2,350	3,000
5	Pagesa për MMPH	6.3	-	25,812	300	36,500	36,500
6	Taksa e ZRRUM`it		-	3,959	2,271	2,576	2,576
7	Shp. Tjera operat.		-	33,824	28,848	40,838	40,438
8	Tatimi në pronë		-	3,441	4,641	15,000	15,000
Gjithsejtë:			1,101,252	1,128,247	1,094,688	1,150,348	1,053,712

ZRRUM nga shuma e shpenzimeve operative të deklaruar nga kjo ndërmarrje ka bërë disa korigjime të disa zëra të shpenzimeve dhe atë; te fondi i pagave është zvogëluar shuma fillestare për 50.266 €, me arsyetimin se ndërmarrja nuk ka ndonjë obligim ligjorë për të pagua pjesën obliguese të të punësuarave në TKPK`ën e cila shprehur në % duket të jetë 20% të fondit të pagave bruto; shpenzimet elektrike janë zbrit në shumë prej 30.000 € duke konsiderua se për furnizim të pjesës së ujit me shumicë për KUR`ët nuk do të duhej të keni një kosto aq të lartë, kjo ka dalë edhe nga fakti se në aplikacion nuk janë saktësua sa dhe si duhet ky grupim i shpenzimeve për njësit shpenzuese dhe si i tillë krijon mëdyshje dhe shuma e shpenzimeve materiale është zvogëluar për 28.380 € me motivacionin e dhënë si te energjia elektrike.

Duke marrë parasysh faktin se sasia e ujit të furnizuar për kategori të ndryshme të konsumatorëve ndryshon (duke eliminuar sasinë e ujit për prodhimin e energjisë elektrike edhe pse ndoshta nuk është e drejtë) është e domosdoshme ti referohemi % së ujit të furnizuar të sistemeve të ujësjellësve regjional me 25,52%, ujit industrial 58,77% dhe ujitjes 15,71%.

Sasia e ujit të furnizuar për ujësjellësit është dhënë te pika 5.2 e cila në % ka këtë pjesëmarrje te:

- KUR “Mitrovica” Sh. A. Mitrovicë 19,04%, dhe
- KUR “Prishtina” Sh. A. Prishtinë për Drenas 6,48%

Totali i shpenzimeve operative të lejuar nga ZRRUM për vitin 2009 është 1.053.712 € dhe nga këto për kompanitë ujësjellësve janë lejuar:

- | | |
|---|---------------------------|
| • KUR “Mitrovica” Sh. A. Mitrovicë | 200.627 €/vit, dhe |
| • KUR “Prishtina” Sh. A. Prishtinë për Drenas | 68.281 €/vit |

Kufiri i përcaktuar i fitimit sipas disa përvojave të shteteve të Evropës Perëndimore është 20,00% e cila mund të llogaritet i mjaftueshëm për të lejuar financimin e disa projekteve të vogla të “Ibër-Lepencit” e cila për këto dy kompani do të rritë shumen e lejuar të shpenzimeve që duhet ti inkasojë kjo ndërmarrje nga KUR`ët për furnizimi me ujë. Fitimi i lejuar është:

- % e lejuar e fitimit nga furnizimi i KUR “Mitrovica” Sh. A. Mitrovicë 40.125 €/vit, dhe
- % e lejuar e fitimit nga furnizimi i KUR “Prishtina” Sh. A. Prishtinë 13.856 €/vit

Totali i shpenzimeve të planifikuara për KUR`ët që duhen të paguajnë “Ibër-Lepencin” gjatë vitit 2009 janë dhënë në vijim me tarifat të veçanta të përcaktuar për të dy KUR`ët:

- Mitrovica: (200.627€+40.125€) 240.752€ me tarifën e këtij cikli prej **0,0153 €/m3**, dhe
- Prishtinën (68.281€+13.856€) 82.137 € me tarifën e këtij cikli prej **0,040 €/m3**

Shkalla e ngritjes së këtyre tarifave në krahasim me tarifat e vitit 2007/08 janë:

- te KUR “Mitrovica” Sh. A. Mitrovicë 5,52%, dhe
- te KUR “Prishtina” Sh. A. Prishtinë 6,10%

5.1. Pagat dhe mëditjet

Në sistemin e pagave dhe të mëditjeve për të punësuarit e drejtpërdrejtë në sektori e ujit me shumicë për furnizim të ujësjellësve regjional janë evidentuar 67 veta dhe në të duhet llogaritet se kanë hy edhe një pjesë të pagave që i përkasin menaxhmentit dhe administratës qendrore e cila është nda në proporcion me sasinë e ujit të furnizuar për këto dy kompani.

ZRRUM mendon se nuk është e drejtë në rrethanat ekzistuese që ndërmarrja për

TKPK të paguaj 20% të shumës bruto të ardhurave të punësuarve dhe ne sugjerojmë që ndërmarrja të zbatojë aktet rregullative që e rregullojnë këtë lëmi. Si rrjedhim i kësaj ZRRUM'i ka zvogëluar shumën e planifikuar të pagave për këtë njësi shërbimi për 50.266 €.

ZRRUM'i sigurisht që bënë vërejtje edhe për lartësinë shumës së pagave të planifikuara për marrje të punësuarve të kësaj ndërmarrje dhe kërkon që të njëjtat të harmonizohen me nivelin pagave të sektorit të furnizimit të ujit për konsumatorët individual në nivel vendi.

5.2. Ri-alokimi i stafit

ZRRUM i është përmbajt marrëveshjes nga procesi paraprak tariforë kur 29 të punësuar nga stafi i ujitjes janë transferuar te njësia e furnizimit me ujë me shumicë të pa trajtuar.

5.3. Pagesat për MMPH

ZRRUM nuk është shumë i bindur për shumën e pritshme për pagesë të shpenzimeve të këtij zëri duke marrë për bazë faktin se ndërmarrja gjatë vitit 2008 ka deklaruar për këtë zë shpenzime në shumën prej 300,00 €. Sidoqoftë ne marrim parasysh deklarinë e kompanisë por do të ishte mirë që shpenzimet e tilla për këtë vit ti bëhen publike ZRRUM'it.

5.4 Ndarja e shpenzimeve të njësisë dhe administratës

Shpenzimet operative për njësinë e ujit dhe pjesa e shpenzimeve të administratës duket të jenë jo shumë të drejta me faktin se ndërmarrja e ka larguar nga skema organizative njësinë e prodhimit si kontribuues ma i madh i të hyrave të saja. Sidoqoftë ne kemi marrë në konsideratë deklarinë e ndërmarrjes, por sugjerojmë se proporcioni i furnizimit me ujë do të duhej të ishte pikënisje për alokim të shpenzimeve në të ardhmen, duke marrë parasysh edhe njësinë e prodhimit të energjisë elektrike.

5.5 Totali i shpenzimeve me kufirin e lejuar të fitimit

ZRRUM'i ka lejuar shumën e shpenzimeve prej 1.053.712 € për vitin 2009 për njësit shfrytëzuese të ujit të Hidrosistemit të "Ibër-Lepencit" (pa prodhimin e energjisë elektrike) dhe në të ka lejuar një shkallë fitimi prej 20% nga llogaritjet e bëra për kalkulim të tarifave të lartë cekura, me motivacion të realizimit të investimeve gjer në lartësinë e shumës së lejuar për menaxhim apo mirëmbajtje ma të mirë të aseteve të veta.

5.6. Tarifa për Mitrovicë

Tarifa e përcaktuar për furnizim të KUR "Mitrovica" Sh. A. Mitrovicë për vitin 2009 është 0.0153 €/m³, për sasinë e ujit të planifikuar për furnizim prej 15.768.000 m³ dhe nga kjo do të realizojë të hyra të përgjithshme prej 241.250 €/vit

5.7. Tarifa për Prishtinë

Tarifa e përcaktuar për furnizim të KUR "Prishtina" Sh. A. Prishtinë për vitin 2009 është 0.040 €/m³, për sasinë e ujit të planifikuar për furnizim prej 2.049.840 m³ dhe nga kjo do të realizojë të hyra të përgjithshme prej 81.994 €/vit.

6. Gjendja financiare

NPH "Iber-Lepenci" Sh. A. Prishtinë është një nga subjektet kryesorë të hidrosistemeve në vend dhe nga veprimtaria e vet realizon të hyra nga disa burime me të cilën financon shpenzimet e afarizmit të vet.

ZRRUM nuk ka njohuri për të hyrat tjera që kjo ndërmarrje ka realizua gjatë vitit 2008 pasi që P/F të këtij viti nuk janë përfundua ende dhe nuk mund të ofrojë ndonjë perspektivë të qartë për tërë sistemin. Nga afarizmi i vetë për shërbimet e furnizimit të dy ujësjellësve regjional e njëjta do të realizoj të hyra të pritshme gjatë vitit 2009 në shumë prej s`paku 323.244 €, me të cilat financon një pjesë të shpenzimeve të veta.

Nga njohuritë tona të bazuar në pasqyrat përmbledhëse financiare në nivel të ndërmarrjes shihet se e njëjta qëndron mirë ekonomikisht dhe se në pasqyrimet e zërave të tillë ka disa paqartësi, e kjo ka të bëjë me shkallen e amortizimit të aseteve ekzistuese të trashëguara.

7. Çështjet rregullatore që duhen të monitorohen

ZRRUM do të angazhohet gjatë këtij viti në monitorimin e kohë pas kohëshme të lartësisë së tarifave të caktuar dhe efektet që ato do ti sjellin kësaj ndërmarrje.

Ndërmarrja duhet ta informojë ZRRUM`in me;

- P/F të dala nga ky vit afarist dhe mundësisht të njëjtat të jenë të licencuar nga ndonjë auditor i pa varur,
- duhet të gjejë një metodologji ma të mirë të pasqyrimet të shpenzimeve sipas njësive shërbyese,
- bëjë zvogëlimin e shpenzimeve për fondin e pagave se është evidente se të njëjtat janë larg mbi mesataren e sektorit që i përket etj.

ZRRUM falënderon personat përgjegjës të kësaj ndërmarrje për angazhimin e treguar për përcaktimin e tarifave të këtij cikli tariforë.